



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2
12.11.2014

NR. VENDIMI 6
03.03.2015

V E N D I M
“PËR KONFISKIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e përbërë nga:

Idriz	MULKURTI	Kryesues
Luan	HASNEZIRI	Anëtar
Iliriana	OLLDASHI	Anëtare

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Demiraj, në Tiranë, në seancë gjyqësore, sot më 03.03. 2015, mori në shqyrtim, kërkesën që ju përket palëve:

KËRKUES (PADITËS): Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Besnik Muçi**.

I PADITUR: **K.N**, i biri i P. dhe M., i dtl.xxx, lindur fshatin xxx, Komuna xxx, xxx, banesë private, përfaqësuar në seancë gjyqësore nga av.M.I. zgjedhur prej tij me deklaram në seancë.

PËRSON I TRETË: **A.L**, administrator i shoqërisë “xxx”, sh.p.k, përfaqësuar në seancë gjyqësore nga av.L.S. sipas autorizimit datë xxx.

OBJEKTI:

1.Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

- a.Shumës prej xxx Euro dhe xxx lekë.
- b.Mjetin tip xxx me targa xxx.

2.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Shërbimi Përmbarimor, ndërsa për **Administrimin dhe përdorimin** e pasurive Z.E.B., i cili është Administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës gjatë bisedimit përfundimtar palët kërkuan:

Paditësi, përfaqësuesi i Prokurorisë, prokurori B.M.:

Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurive të mëposhtme:

- a. Shuma prej xxx euro dhe xxx lekë.
- b. Mjetin tip xxx me targa xxx.

Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet shërbimi përmbarimor, ndërsa për administrimin e pasurive z. E.B, i cili është administrator në Agjensinë e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave.

Përfaqësuesi i palës së paditur av.M.I:

Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kthimin e vlerave monetare përsonit të tretë A.L.

Kthimin e autoveturës pronarit të ligjëshëm shtetasit K.N.

Përfaqësuesit përsonit të trete av.L.S:

Rrëzimin e kërkesë padisë së paraqitur nga prokuroria pranë kësaj gjykate.

Kthimin e vlerës së sekuestruar shtetasit A.L. si pronar.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të prokurorit, provat e paraqitura nga palët në gjykim dhe si degjoi kërkesen e tyre përfundimtare

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë,

në datë xxx, regjistroi proçedimin pasuror nr.x, Viti xxx, në ngarkim të shtetasit K.N., si person i dyshuar për kryerje të veprës penale “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Ky proçedim pasuror është rregjistruar si rrjedhojë e proçedimit penal nr.xxx, të vitit xxx, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në ngarkim të shtetasve A.M., B.E., B.D., M.O., A.T., G.Xh., për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, si dhe në ngarkim të shtetasit K.N., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Nga materiali hetimor i proçedimit penal nr.xxx, të vitit xxx, të administruar edhe për llogari të proçedimit pasuror nr.xxx, të vitit xxx të Prokurorisë për Krime të Rënda, ka rezultuar sa më poshtë:

Se shtetasit K.N. në datën xxx, i është seksuestruar një sasi prej xxx kg lëndë narkotike e llojit Cannabis Sattiva. Prokuroria për Krime të Rënda, në përfundim të hetimit i ka njoftuar shtetasit K.N. akuzën e “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe ka vendosur dërgimin në Gjyq të çëshjes penale në ngarkim të tij.

Nga aktet e hetimit të proçedimit penal në ngarkim të shtetasit K.N. ka rezultuar se atij në momentin e arrestimit i janë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë, dhe mjetin tip xxx me targa xxx së bashku me dokumentacionin e tij.

Në kushtet e mësipërme, Prokuroria për Krime të Rënda ka pretenduar se ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur ne prova se shtetasi K.N. ka kryer veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Ndodhur në të tilla rrethana, nga ana e organit procedues kanë filluar procedurat për vendosjen e masave parandaluese ndaj pasurive, duke qënë se kjo vepër penale hyn në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive” dhe si rrjedhojë dhe për këtë shtetas sipas nenit 3/1 të këtij ligji duhet të kryhej hetim pasuror dhe të aplikohen masat e parashikuara nga ky ligj.

Nga verifikimet pasurore të kryera për llogari të procedimit pasuror në ngarkim të shtetasit K.N., ka rezultuar se ai disponon dhe pasurinë e llojit arë me nr. xxx, regjistruar në zonën kadastrale nr.xxx, volumi xxx, faqja xxx, në xxx, xxx, në datën xxx. Kjo pasuri është krijuar para periudhës së aktivitetit kriminal si dhe para vitit xxx, periudhë e cila përkon përpara hyrjes në fuqi dhe shtrirjes së efekteve të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”. Në këto kushte bazuar në nenin 3/4 të këtij ligji, ky ligj nuk zbatohet për këtë pasuri.

Gjithashtu, nga Prokuroria për Krime të Rënda janë kryer dhe verifikime lidhur me të ardhurat e shtetasit K.N. dhe sipas përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr.xxx, datë xxx dhe QKR me nr.xxx, datë xxx, ky shtetas nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat dhe nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin tregtar. Në këto kushte, për prokurorinë është evindentuar fakti se shtetasi K.N. nuk rezulton që të ketë të ardhura të tjera nga burime të ligjshme për të justifikuar shumën prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë që dispononte në momentin e arrestimit në flagrancë.

Sipas prokurorisë nga hetimet e kryera për llogari të procedimit pasuror, ka rezultuar se pasuria e mësipërme është krijuar pas periudhës së aktivitetit kriminal dhe pas vitit xxx, viti i hyrjes në fuqi dhe shtrirjes së efekteve të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive” dhe si rrjedhojë ky ligj zbatohet për këtë pasuri. Në këto kushte, me datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka paraqitur kërkesë para kësaj Gjykate, me objekt sekuestrimin e pasurive të përshkruara më sipër, duke pasur si bazë ligjore ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur, me vendimin e saj nr.xxx, datë xxx ka vendosur:

“Vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë e shtetasit K.N., të

përbërë prej:

Shumës prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë

Mjetin tip xxx me targa xxx”.

Kundër këtij është bërë ankim nga i padituri nëpërmes mbrojtësit të tij dhe Gjykata e Apelit me vendimin nr.xxx, datë xxx, ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar.

Gjatë hetimit gjyqësor, Gjykata bazur të nenin 193 të K.Pr.Civile si dhe në lidhje me nenin 22/3 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”, pasi dëgjoi dëshmitarin A.L., e mori atë me cilësinë e personit të tretë, sepse ai deklaroi se shumta prej xxx euro ishte e tija, pasi ai ja kishte dhënë borxh të paditurit.

Pretendimet e palëve në seancë gjyqësore:

A.Prokurori me cilësinë e paditësit:

1. Është provuar dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi K.N. ka kryer veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, e cila hyn në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”, dhe si rrjedhojë ky shtetas sipas nenit 3/1 të këtij ligji është subjekt i këtij ligji dhe i hetimit pasuror.

2. Ne momentin e arrestimit shtetasit K.N., i është gjetur dhe sekuestruar shumta prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë dhe mjetin tip xxx me targa xxx së bashku me dokumentacionin e tij, veprim i cili është vleftësuar i ligjshëm nga prokurori. Nga verifikimet e kryera lidhur me të ardhurat e shtetasit K.N., sipas përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr.xxx, datë xxx dhe QKR me nr.xxx, datë xxx, ky shtetas nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat dhe nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, dhe për rrjedhojë nuk justifikon shumën monetare të sekuestruar ndaj tij gjatë arrestimit.

3. Pasuria e mësipërme në pronësi të shtetasit K.N., është krijuar pas periudhës së aktivitetit kriminal dhe pas vitit xxx, viti i hyrjes në fuqi dhe shtrijes së efekteve të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”, dhe si rrjedhojë ky ligj zbatohet për këtë pasuri.

4.Nga verifikimet e kryera nuk rezulton që shtetasi K.N. të ketë aktivitet privat apo të ardhura të tjera të ligjshme që të justifikojë zotërimin e këtyre pasurive. Pra zotërimi i këtyre pasurive nuk i përgjigjet dukshëm nivelit të ardhurave, ndaj këto pasuri duhet të konfiskohen.

5. Provat e paraqitura nga i padituri nuk provojnë faktet e pretenduara nga ai sepse:

Së pari: Pretendimin se shumën e parave e kishte marrë borxh dhe se mjetin ia kishte blerë nipi të tij, nuk e ka paraqitur në momentin e arrestimit të tij dhe sekuestrimit të këtyre sendeve në kuadrin e procesit penal.

Së dyti: Burimi i kësaj pasurie si mjeti i blerë dhe shuma e marrë borxh pretendohet të jetë nipi i të paditurit, dëshmitari N.N., deklaratimet e të cilit për shkak të lidhjeve shumë të afërta janë të pabesueshme.

Së treti: Asnjë nga veprimet e pretenduara nga i padituri nuk është kryer me dokument qoftë edhe thjesht shkresore, pavarësisht faktit se janë shuma të konsiderueshme parash dhe dhënia e tyre borxh pa asnjë dokument dhe garanci nuk është e besueshme.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet si më poshtë:

Vendim i datës xxx, për regjistrimin e procedimit pasuror nr.xxx, të vitit xxx; Relacion për kalimin e akteve të Seksionit të Hetimit Pasuror; Urdhëri i datës xxx, për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 të K.Penal; Urdhëri i datës xxx për regjistrimin e emrit të shtetasit K.N., në regjistrin e veprave penale; Vendim i datës xxx, për marrjen e të pandehurit dhe njoftimin e akuzës, shtetasit K.N., për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/2 i Kodit Penal; Vendimi i datës xxx, për dërgimin në gjyq të procedimit penal

nr.xxx, të vitit xxx; Shkresa nr.xxx, datë xxx, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx; Procesverbal i datës xxx, i Oficerit të Policisë Gjyqësore I.M., për sekuestrimin e sendeve shtetasit K.N., konkretisht shumave prej xxx Euro dhe xxx Lekë; Vendim i datës xxx, i Prokurorit A.B., për vleftësimin e ligjshëm të sekuestrimit të kryer nga Oficeri i Policisë Gjyqësore I.M.; Urdhër i datës xxx, për depozitimin e shumave prej xxx euro dhe xxx lekë në xxx Bank; Procesverbal i datës xxx, i Oficerit të Policisë Gjyqësore Z.M. për sekuestrimin e mjetit tip xxx me targa xxx, së bashku me dokumentacionin e mjetit; Vendim i datës xxx i prokurorit A.B. për vleftësimin e ligjshëm të sekuestrimit të kryer nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Z.M; Procesverbal për lënien në ruajtje pranë parkut të Ministrisë së Brendëshme të mjetit me targa xxx; Çertifikatë familjare e Zyrës së Gjendjes Civile xxx e shtetasit K.N., dy copë; Shkresa nr.xxx, datë xxx, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me shtetasin K.N.; Shkresa nr.xxx, datë xxx e QKR lidhur me shtetasin K.N.; Shkresa nr.xxx, datë xxx e ZRPP xxx, lidhur me pasuritë e shtetasit K.N.; Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr.xx, datë 17.04.2014, për sekuestrimin e pasurive të shtetasit K.N.; Raport i Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara lidhur me ekzekutimin e vendimit dhe gjendjen e pasurive nr.xxx, datë xxx; Kërkesë ankimore datë xxx e të paditurit K.N., bërë ndaj vendimit nr.xxx, datë xxx, për sekuestrim pasurie; shkresë xxx datë xxx, e drejtorisë rajonale të transpourtit xxx bashkëngjitur kopje e dosjes së mjetit me targa xxx.

B.Përfaqësuesi i të paditurit K.N. av.M. I.:

1.Pranon faktin se i padituri K.N. është arrestuar e më pas dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 283 i K.Penal, pasi në mjetin e tij janë gjetur e sekuestruar 4 kg lëndë narkotike. Në momentin e arrestimit i janë gjetur e sekuestruar xxx euro e xxx lekë si dhe i është sekuestruar mjete që ishte në pronësi të tij.

2.K.N. ka ardhur për gjykim me disa persona të tjerë në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe kjo gjykatë me datë xxx, në kushtet kur gjithë të pandehurit e tjerë ishin prezent ndërsa K.N. nuk ishte prezent, pasi ishte i shtruar në spital dhe ishte në pamundësi ardhje, pra kishte një shkak të ligjshëm

dhe për këtë gjykata ka vendosur: “Ndarjen e çeshtjes penale në ngarkim të pandehurit K. N. nga të pandehurit e tjerë dhe dërgimin e akteve në ngarkim të tij Gjykatës së rrethit Gjyqësor xxx për vazhdimin e gjykimit si gjykatë kompetente”.

3. Gjukata e Rrethit Gjyqësor xxx, me vendimin nr.xxx, datë xxx, vendim i cili ka marrë farmë të prerë me datë xxx, ka dënuar të paditurin për veprën penale parashikuar nga neni 283 i K.Penal, ndërsa për provat materiale objekt i këtij gjykimi, siç janë vlerat monetare dhe automjeti ka vendosur ti kthehen të paditurit K.N., pasi nuk janë produkt i veprës penale.

4. Lidhur me kërkesën për konfiskimin e pasurisë, sekuestruar me vendimin nr.xxx, datë xxx, mbrojtësi pretendon se ato nuk duhen konfiskuar, pasi ato janë të ligjshme dhe sipas nenit 21/2 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009, barra e provës për të provuar i takon paditësit dhe në këto kushte për të provuar ligjshmërinë e tyre parashtroj si më poshtë:

Së pari: Pasuritë që kërkohen të konfiskohen janë sekuestruar fillimisht në momentin e arrestimit dhe ky sekuestrim është vleftësuar i ligjshëm nga prokurori. Mirëpo Gjukata e Rrethit Gjyqësor xxx me vendim të formës së prerë ka urdhëruar kthimin e këtyre pasurive shtetasit K.N., pasi nuk është provuar se kanë lidhje me veprën penale për të cilën është dënuar.

Së dyti: Pretendimi i prokurorit se subjekti K.N. nuk arriti të jsutifikojë sendet e sekuestruara në momentin e arrestimit nuk është e vërtetë sepse:

a Kur jemi pyetur për efekt të këtij procedimi nga OFPGJ, kemi shpjeguar se vlera monetare e gjetur dhe sekuestruar është marrë borxh për të blerë një banesë në xxx. Për të kemi dhënë emrat e personave që na kanë dhënë borxhin dhe emrin e atij që do blinim truallin, kemi kërkuar që ato të pyeten për të vërtetuar pretendimet tona, por nuk është marrë parasysh kjo kërkesë. Kemi shpjeguar se dhe makina është blerë nga nipi, dëshmitari N.N. Nisur nga kjo situatë kemi kërkuar me një memo me datë xxx, Prokurorisë për Krime të Rënda kthimin e këtyre sendeve sepse nuk kanë pasur asnjë lidhje me veprën për të cilën hetoheshim për të cilën nuk kemi marrë përgjigje.

b Vlerat monetare ja kemi marrë borxh shtetasit A.L. për të blerë banesën e R.S. me banim në xxx. A. u paraqit në gjykatë ku nën

betim deklaroj se K.N. e njihte familjarisht dhe ja kishte dhënë borxh xxx euro, për të blerë shtëpi në xxx, ku si garant për këtë borxh kishte hyrë dëshmitari N.N. të cilin e njihte pasi kishte dhe marrëdhënie pune me të prej më shumë se 10 vjet. Ky për të hequr dyshimin për fuqinë paguese dhe aftësinë e tij financiare paraqiti para gjykatës, pasqyrat financiare të viteve xxx e xxx ku rezultoi se kishte patur fitim përkatësisht xxx euro e xxx euro.

c. Dëshmitari R.S. pohoi para gjykatës se kishte një banesë për ta shitur në xxx dhe për këtë kishte rënë dakort për t'ia shitur në vitin xxx shtetasit K.N.

d Dëshmitari N.N. pohoi në gjykatë, se mjetin që i ishte sekuestruar shtetasit K.N. ja kishte blerë ai së bashku me vëllezërit e tij, pasi ai ishte i vetëm e i sëmurë, po kështu ai ishte bërë garant tek dëshmitari (përsoni i tretë) A. L. për të marrë xxx euro borxh të cilat do ë përdoreshin nga K. për të blerë banesën tek dëshmitari R. S.

Për të provuar sa sipër përveç provave e akteve paraqitur nga prokurori mbrojtësi paraqiti para gjykatës këto akte.

Vendimi nr.xxx datë xxx i Gjykatës së Rretht Gjyqësor xxx i cil ka marrë formë të prerë me datë xxx; Kërkesë datë xxx paraqitur prokurorit, për kthimin e vlerave monetare; Praktika shëndetësore e shtetasit K.N.; Pasqyrat finnaciare të xxx shpk me administrator A.L. për vitet xxx, xxx, xxx si dhe me cilësinë e dëshmitarëve shtetasit N.N., A.L. e R. S.

Përsoni tretë A.L. administrator i Shoqërisë “xxx” shpk përfaqësuar nga av.L. S.

Në seancën gjyqësore është paraqitur me cilësinë e dëshmitarit A.L, administrator i subjektit “xxx” sh.p.k, i cili ka shpjeguar se:

Ka njohje familjare me shtetasin K.N. dhe për këtë shkak të këtyre njohjeve si dhe garancive që kishte te nipi i tij N.N., i ka dhënë këtij shtetasi në muajin maj xxx, pa akt të shkruar noterial dhe pa interes vlerën prej xxx euro borxh për të blerë një shtëpi në xxx. Jemi në dijeni se kjo shumë i është sekuestruar pasi ka patur probleme me drejtësinë.

Për të provuar aftësinë financiare si dhe për të larguar çdo lloj dyshimi paraqitëm bilancin e viteve xxx e xxx të shoqërisë që drejton A.L.,

nga ku duket fare e qartë se fitimi i saj i plotëson kushtet për të dhënë borxh më shumë se shumën e sekuestruar.

Në përfundim kërkoj kthimin e shumës shtetasit A.L. si pronar.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

Gjykata në analizë të pretendimeve të palëve si dhe provave dhe akteve që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, vlerëson si më poshtë:

Së pari: Ashtu siç pranojnë palët i padituri K.N, për shkak të dënimit të dhënë ndaj tij për veprën penale parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, është subjekt për procedimin pasuror për pasurinë e sekuestruar në momentin e arrestimit.

Së dyti: Se subjektit të këtij procedimi K.N. i takon barra e provës për të provuar se pasuria sekuestruar me vendimin nr.xxx, datë xxx, për të cilën kërkohet konfiskimi nga prokuroria është e ligjshme.

Së treti: Nga aktet e paraqitura rezulton se, që në momentin kur po zhvillohej hetimi për procedimin penal në ngarkim të paditurit K.N., nga mbrojtja është pretenduar se pasuria e sekuestruar është e ligjshme dhe se nuk ka lidhje me veprën që është arrestuar i dyshuari. Për këtë ka kërkuar të pyeten personat që e vërtetojnë një pretendim të tillë, por një gjë e tillë nuk është pranuar nga prokuroria, po kështu gjatë hetimit me datë xxx, ka kërkuar kthimin e këtyre provave. Një pretendim të tillë e ka pasqyruar dhe në ankimin e bërë ndaj vendimit të sekuestrimit.

Së katërti: I padituri është person që ka patur probleme shëndetësore në vijimësi, kjo provohet me aktet e paraqitura gjatë gjykimit, ashtu dhe me faktin se si pasojë e mosparaqitjes së tij për shkaqe shëndetësore në gjykim në Gjykatë e Krimeve të Rënda është ndarë çeshjta në ngarkim të tij, duke dërguar atë për kompetencë në Gjykatën e xxx.

Së pesti: Me vendim të formës së prerë Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx ka vendosur ti kthejë provat materiale të paditurit K.N., pasi ka konkluduar se nuk janë produkt i veprës penale.

Së gjashti: Gjatë seancave gjyqësore me provat me dëshmitarë u provua se shumat monetare xxx euro e xxx lekë të sekuestruara janë marrë borxh, tek personi i tretë A.L. i cili është administrator i shoqërisë xxx

sh.p.k, e kishte mundësi të jepte borxh, (pasi kishte aktivitet privat me fitim më të madh nga shuma e dhënë borxh) me qëllim që shtetasi K.N. të blinte një banesë në qytetin e xxx, ku të ishte më afër kujdesit shëndetësor, pasi ai ishte i vetëm dhe vazhdimisht kishte probleme shëndetësore. Po kështu u provua se mjete me targa xxx i është blerë shtetasit K.N. nga kontributi i dëshmitarit N.N me vëllezërit e tij (nga të ardhurat e tyre), për vetë faktin se K. ka qënë i vetëm dhe vazhdimisht ka patur probleme shëndetësore.

Si përfundim, gjykata konkludon se kërkesa e paraqitur nga prokuroria për konfiskimin e pasurive të sipërcituar nuk duhet pranuar, pasi nga provat e aktet që paraqiti i padituri në këtë gjykim u provua, se kjo pasuri është e ligjshme dhe nuk është produkt i veprës penale për të cilën është dënuar i padituri. Në këto kushte, këto pasuri duhet t'i kthehen të paditurit K.N.

Sa sipër u provua gjatë seancave gjyqësore me shpjegimet e palëve dhe provat e aktet shkresore të paraqitur prej tyre të cilat ju nënshtuan hetimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 306-310 e vijues te K.Pr.Civile si dhe nenet 3, 21, 24 dhe 28/2 e vijues ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive*"

V E N D O S I

1. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë Për Krime të Rënda Tiranë, me objekt konfiskimin e shumës prej xxx euro e xxx lekë dhe mjetin tip xxx me targa xxx.

2. Heqjen e masë së së sekuestros mbi këto sende, vendosur me vendimin nr.xxx, datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

3. Urdhërohet Agjensia e Administrimit te Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe zyra e Përmbartimit përkatës për ekzekutimin e këtij vendimi, duke i kthyer sendet e sekuestruara, shumën prej xxx euro e xxx lekë dhe mjetin tip xxx me targa xxx, të paditurit K.N.

4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë kopjen e këtij vendimi Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe të Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor përkatës.

5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, nga palët Brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall në Tiranë më datë 03.03.2015

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Valbona DEMIRAJ

Idriz MULKURTI

